



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.
___.2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr. 95, datë 17.03.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) TË
GJYQTARES {...}

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR
ÇDO KRITER VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

**1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E
ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE**

POLI I DREJTËSISË

RRUGA “ANA KOMNENA”

TIRANË

organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Gjyqtare {...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dosja penale e vëzhguar konfirmon njohuri procedurale të gjyqtares mbi mjetet e kërkimit të provës gjatë fazës së hetimeve paraprake (dosja 1). Katër dosjet gjyqësore civile të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj mbi të drejtën familjare për shkak se në periudhën e rivlerësimit gjyqtarja ka qenë pjesë e seksionit familjar të dhomës civile. Përzgjedhja e vendimeve të paraqitura nga subjekti është e tillë që referon në gjykime për vepra penale të ndryshme, në gjykime me procedurë të zakonshme ashtu edhe atë të shkurtuar, duke konfirmuar njohuritë në shumëllojshmërinë e veprave penale në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë për krime të renda: trafikim personi, shfrytëzim prostitucioni, prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të ftohta, prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit (dokumenti 1), trafikim narkotikës (dokumenti 2), shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie (dokumenti 3). Këto vendime konfirmojnë gjithashtu njohuri të gjyqtares në institute të ndryshme të pjesës së përgjithshme të së drejtës penale si: grupi i strukturuar kriminal si formë e veçantë e bashkëpunimit, gjykimi i shkurtuar, rregullat për caktimin e dënimit përfshi bashkimin e dënimeve...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi në rastin konkret ndahen në dy grupe kryesore për shkak të lëndës, kategorizim i cili afekton edhe mënyrën e përcaktimit dhe analizimit të fakteve të çështjes. Për shkak të natyrës së ndryshme të burimeve të vlerësimit, analiza e elementëve të këtij treguesi bëhet në mënyrë të veçantë.

Në çështjet civile-familjare, gjyqtarja përcakton dhe përshkruan në mënyrë të përmbledhur faktet e çështjes në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, duke integruar edhe provat mbi të cilat kanë rezultuar të provuara faktet konkrete. Në nënndarjen e titulluar “*Rrethanat e çështjes*”, përveç

përshkrimit të fakteve thelbësore të çështjes, gjyqtarja evidenton edhe qëndrimin e palëve të mbajtur sipas rastit, në seancë pajtimi apo seancë gjyqësore, si dhe kërkimet e tyre në raport me objektin e mosmarrëveshjes. Për shkak të natyrës specifike të çështjeve të trajtuara (çështje me objekt zgjidhje martesë, ndryshim i masës së detyrimit ushqimor ose lëshim urdhër mbrojtje), evidentimi i qëndrimit të palëve lidhur me objektin e mosmarrëveshjes dhe kërkimet objekt padie (lidhur me pasojat e zgjidhjes së martesës apo kërkimin për masat mbrojtëse ndaj dhunës) bëhet pjesë e përshkrimit të rrethanave të faktit, duke u paraqitur në mënyrë të përmbledhur. Përveç përshkrimit të fakteve të çështjes në pjesën hyrëse të arsyetimit të çdo vendimi, së bashku me referimin tek provat mbi të cilat mbështeten faktet konkrete, në rastet në të cilat është kryer akt ekspertimi psikologjik, kjo provë përshkruhet në pjesën e dytë të vendimit që ka të bëjë me arsyetimin ligjor të gjykatës, duke referuar pjesë të aktit të ekspertimit në shërbim të konkluzioneve të gjyqtarës sa i përket marrëdhënies së fëmijëve me prindërit dhe lënies së tyre për rritje dhe edukim.

Në çështjet penale, në 6 vendimet e analizuara, referuar natyrës së gjykimit (gjykim penal themeli ose kërkesë penale) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi specifike përcaktimit të fakteve të çështjes dhe përshkrimit në mënyrë të detajuar të tyre në një ose disa pjesë të arsyetimit të vendimit, në varësi të kompleksitetit të faktit penal apo volumit të rrethanave të faktit të cilat determinojnë edhe mënyrën e paraqitjes dhe analizimit të tyre. Në disa vendime, në pjesën e parë të arsyetimit të titulluar “Rrethanat e çështjes”, gjyqtarja përshkruan fillimisht ecurinë procedurale të çështjes duke ndjekur një rend kronologjik në përshkrimin e saj dhe më pas vijon me përshkrimin e faktit penal të provuar në gjykim. Më pas, fakti rimerret në analizë duke iu referuar përshkrimit dhe vlerësimit të të gjitha provave të marra, në një pjesë të dytë të arsyetimit të vendimit, në të gjitha vendimet e analizuara, përveç vendimit me nr. 210, datë 19.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimit nr. 109, datë 10.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në të cilët fakti penal përshkruhet dhe analizohet së bashku me analizën e provave vetëm në një pjesë të vendimit, për shkak të natyrës jo komplekse të çështjeve (kërkesë penale për sekuestrim të dhënash dhe gjykim themeli për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal).

Në të gjitha vendimet e tjera, për shkak të kompleksitetit dhe volumit të fakteve, paraqitja në mënyrë përshkruese dhe të detajuar e tyre në pjesën e parë të vendimit, vijon me rimarrjen në analizë të tyre në vijim të pjesës arsyetuese të vendimit, duke ia nënshtruar faktin penal një analize të mirëfilltë, të detajuar dhe të plotë të provave mbi të cilat ai mbështetet.

Në vendimet nr. 22, datë 03.03.2016, nr. 42, datë 04.04.2016 dhe nr. 107, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për shkak të kompleksitetit të çështjeve, numrit të të pandehurve dhe volumit të provave, gjyqtarja ka ndjekur një tjetër metodologji të paraqitjes së faktit penal, nëpërmjet përshkimit të tij në pjesën e titulluar “Rrethanat e faktit”, si dhe rimarrjen në analizë të detajuar dhe specifike të faktit nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të veçantë dhe të integruar të çdo prove të marrë në shqyrtim. Në këto tre vendime, për shkak të kompleksitetit të çështjeve diktuar nga vetë fakti penal, gjyqtarja i ka kushtuar një rëndësi specifike paraqitjes, analizës së mirëfilltë dhe të plotë të provave në lidhje me çdo rrethanë si dhe rolin e secilit të pandehur në kryerjen e veprës penale, duke nxjerrë në fund të çdo analize edhe faktet përkatëse të provuara, në formën e listimit të tyre.

Rendësi e posaçme në këto tre vendime, i kushtohet edhe analizës së integruar të provave me qëllim evidentimit e elementëve specifike të faktit penal në lidhje me rrethana të tilla si bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si element cilësues ose rrethanë rënduese apo si formë e veçantë bashkëpunimi, formës së kryerjes së veprës penale, qëllimit të veprës në rastin kur ai përbën element të domosdoshëm të figurës së veprës penale¹. Po ashtu, në të gjitha vendimet penale të analizuara, gjyqtarja i kushton rëndësi evidentimit dhe analizës së fakteve të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit si dhe aplikimit të alternativave të dënimit me burgim². Në këto raste, faktet përkatëse janë marrë në analizë në fund të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, duke i analizuar ato në mënyrë specifike dhe konkrete së bashku me kriteret ligjore të përcaktimit dhe individualizimit të dënimit.

Karakteristikë e gjyqtares, në çështjet komplekse me disa fakte penale dhe disa të pandehur, është renditja në një paragraf përmblyës të analizës, në mënyrë të përmbledhur e fakteve specifike që kanë rezultuar të provuara duke i renditur ato, çka i jep qartësi konkluzionit të gjykatës në lidhje me faktin penal në çështje të cilat përfshijnë disa episode ose disa fakte penale njëkohësisht, të cilat qëndrojnë të veçuar nga njëri – tjetri.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara (civile dhe penale), natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i gjykimit dhe analiza e faktit penal ose civil, pavarësisht se nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur nga gjyqtarja në të gjitha vendimet. Identifikimi dhe përshkrimi i qartë dhe i saktë i faktit juridik prej saj, sjell si pasojë përcaktimin e saktë të marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve në rastin e çështjeve civile, apo të e natyrës së çështjes penale objekt shqyrtimi, si dhe përcakton mënyrën e organizimit të arsyetimit të vendimit, e cila është e ndryshme në bazë të lëndës (civile familjare, kërkesë penale apo çështje penale themeli).

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon qartë ligjin e zbatueshëm, citon në disa raste dispozita të ligjit material ose procedural, por në mënyrë të kufizuar dhe vetëm në raste kur citimi i tyre i shërben analizës ligjore të dispozitës.

Duke i ndarë burimet e vlerësimit në dy kategori (i) vendime civile-familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material, rezulton se:

Në vendimet civile (çështje me objekt zgjidhje martesë, lëshim urdhër mbrojtje dhe ndryshim vendimi në lidhje me detyrimin), gjyqtarja identifikon dhe referon drejtpërdrejt në pjesën hyrëse të vendimit, pas bazës ligjore të padisë, nenet 41 dhe 51 të K.Pr.C lidhur me vlerësimin për

¹ Vendimi nr. 42/04.04.2016, nr.107/14.09.2016 dhe nr. 22/03.03.2016

²Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016

juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës, si pjesë e një konkluzioni paraprak të saj në lidhje me ekzistencën e juridiksionit gjyqësor civil dhe kompetencën lëndore dhe tokësore në gjykimin e çështjes.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në të gjitha çështjet me objekt zgjidhje martesë gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm (i) nenin 132 të Kodit të Familjes, i cili është cituar në çdo vendim shoqëruar me analizën në mënyrë të shkurtuar të përmbajtjes së tij sa i përket kushteve të zgjidhjes së martesës më kërkesë të njërit bashkëshort; (ii) nenet 146, 158, 161, 192 dhe 197 të Kodit të Familjes, në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës lidhur me mbiemrin e bashkëshortit, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim, përcaktimin e të drejtës së takimit si dhe detyrimin për ushqim të prindit ndaj fëmijës së mitur. Gjithashtu, në këto vendime identifikohet si ligj i zbatueshëm neni 5 dhe 166 i Kodit të Familjes në lidhje me pyetjen e fëmijës së mitur nga gjykata³ dhe kryerjen e aktit të ekspertimit psikologjik. Ndërkohë në vendimin me objekt lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, duke referuar në përmbajtje të vendimit nenin 10 të tij në lidhje me masat mbrojtëse.

Në vendimet penale, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi specifike identifikimit, referimit dhe analizës së ligjit të zbatueshëm, procedural dhe material, në vendin e duhur të pjesës arsyetuese dhe në shërbim të analizës ligjore të çështjes.

Në lidhje me ligjin procedural penal, identifikon si ligj të zbatueshëm dhe analizon kur është rasti (i) nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar⁴; (ii) nenin 152 të K.Pr.P në lidhje me vlerësimin e provave⁵; (iii) nenin 16 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e lidhjes mes të pandehurit dhe të dëmtuarës; (iv) nenin 190 dhe 191 të K.Pr.P në lidhje me disponimin për provat materiale; (v) nenin 75/a të K.Pr.P dhe nenin 5 të ligjit nr. 9110 datë 24.07.2003 në lidhje me vlerësimin paraprak (nëpërmjet një fjalie në pjesën hyrëse të arsyetimit) për kompetencën lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda; (vi) nenin 208/a të K.Pr.P në lidhje me kushtet ligjore të lejimit për marrjen dhe sekuestrimin e të dhënave kompjuterike⁶; (vii) nenin 375 të K.Pr.P në lidhje me ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal⁷; (viii) nenin 35 të K.Pr.P në lidhje me të drejtat dhe garancitë procedurale të të pandehurit të mitur⁸; (ix) nenin 193/5 të K.Pr.P në lidhje me efektet e vendimit të formës së prerë ndaj bashkë të pandehurve⁹.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja identifikon saktë dispozitat materiale penale, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurve. Konkretisht, gjyqtarja identifikon nenet specifike të Kodit Penal mbi të cilat bëhet kualifikimi ligjor i faktit/fakteve penale, për të cilat akuzohen të pandehurit në çdo çështje dhe konkretisht : (i) nenin 134 të Kodit Penal në lidhje me

³Vendimi nr. 515, datë 17.03.2014 të Gj.Rr.Gj.Elbasan.

⁴Vendimi nr. 109, datë 10.02.2014 i Gj.Rr.Gj.Elbasan, nr. 45, datë 06.04.2016, nr. 22, datë 03.03.2016, nr. 42, datë 04.04.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁵Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁶Vendimi nr.210, datë 19.12.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁷Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁸Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016

⁹Vendimi nr. 42, datë 04.04.2016

veprën penale të vjedhjes¹⁰; (ii) nenin 109/b të K.P në lidhje me veprën penale “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”¹¹; (iii) nenet 110/a/4, 114/2, 279 dhe 278 të K.P në lidhje me veprat penale “Trafikimi i personave të rritur”, “Shfrytëzimi i prostitucionit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”¹²; (iv) nenin 227 të Kodit Penal në lidhje e veprën penale të “Vetëgjyqësisë” i cili analizohet në drejtim të pretendimeve të mbrojtës së të pandehurve për ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit¹³; (v) nenet 283/a/2, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal sa i përket veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve” si dhe elementëve të veprave penale të “Grupit të strukturuar kriminal” dhe kryerjes se veprës penale në kuadër të grupit të strukturuar¹⁴; (vi)nenin 128/b/3 të Kodit Penal sa i përket veprës penale të “Trafikimit të të miturve”, nga analiza e të cilit është arritur në konkluzionin për ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal, në lidhje me njërin nga faktet e çështjes¹⁵; (vii) nenin 300 të Kodit Penal sa i përket pretendimit të mbrojtjes për kualifikimin e faktit penal ndaj njërit prej të pandehurve si “Moskallëzim krimi” dhe jo si bashkëpunim në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohej i pandehuri¹⁶.

Gjithashtu, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, si:

- (i) nenin 25 të Kodit Penal në lidhje me bashkëpunimin, kuptimin e tij, elementët e anës objektive dhe subjektive të bashkëpunimit kur ai përben rrethanë rënduese të veprës penale¹⁷ ose rrethanë rënduese¹⁸ ;
- (ii) (nenin 3 të Kodit Penal në lidhje me përcaktimin e zbatimit të ligjit penal material në kohë si dhe zbatimin e ligjit penal favorizues¹⁹;
- (iii) nenet 25 dhe 28 të Kodit Penal në lidhje me format e veçanta të bashkëpunimit dhe karakteristikat e bashkëpunimit, për t’u cilësuar si i tillë²⁰;
- (iv) format e veçanta të kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve” apo “Trafikimit të genieve njerëzore”, duke iu referuar për përcaktimin e tyre dispozitës së posaçme të Kodit Penal së bashku me referimin e parashikimeve të Ligjit “Për lëndët narkotike dhe barnat psikotrope” si dhe Konventave respektive të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara;
- (v) kriteret ligjore të individualizimit të dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke referuar parashikimet e nenit 47, 48 dhe 49 të kodit Penal të cilat janë referuar dhe analizuar në secilin nga vendimet penale të themelit;
- (vi) nenin 55 të Kodit Penal në lidhje me institutin e bashkimit të dënimeve, sistemet e bashkimit të dënimeve si dhe në një rast vlerësimin e parashikimeve të këtij neni në raport me zbatimin në kohë të ligjit penal dhe zbatimin e ligjit penal favorizues²¹;

¹⁰Vendimi nr. 109, datë 10.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

¹¹Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016 dhe vendimi nr. 107, datë 14.09.2016

¹²Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016

¹³Vendimi nr. 107, datë 14.09.2016

¹⁴Vendimi nr. 42, datë 04.04.2016

¹⁵Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016

¹⁶Vendimi nr. 107, datë 14.09.2016

¹⁷Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016 dhe vendimi nr. 107, datë 14.09.2016

¹⁸ Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016 dhe nr. 42, datë 04.04.2016

¹⁹Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016

²⁰Vendimi nr. 42, datë 04.04.2016

³¹ Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016

- (vii) nenin 51 të Kodit Penal lidhur me përcaktimet ligjore në lidhje me caktimin e masës së dënimit për të pandehurit e mitur;
- (viii) nenin 59 në lidhje me aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurve në provë, si dhe
- (ix) nenin 60 të këtij Kodit sa i përket detyrimeve të të dënuarit gjatë kohës së provës²².

Në disa raste, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm, për efekte krahasimore ose për të nxjerrë kuptimin e dispozitave të veçanta të ligjit penal shqiptar, edhe dispozita të akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të se drejtës, si më poshtë:

- (i) neni 4 i Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, duke lidhur kuptimin e veprimeve, mjeteve, formave të shfrytëzimit sipas këtij neni me nenin 110/a të Kodit Penal²³;
- (ii) dispozita të Konventës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” sa i përket elementëve procedurale të marrjes së provave, lidhur me kuptimin e nenit 509 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale”²⁴;
- (iii) dispozita të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar në lidhje me formën e veçantë të bashkëpunimit në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, në raport me parashikimet e nenit 28 të Kodit Penal që parashikon këtë formë bashkëpunimi²⁵;
- (iv) dispozita të Konventës Evropiane “Për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo poshtërues” si dhe dispozita të Konventës Kundër Torturës së OKB, në lidhje me përcaktimin e kuptimit të termave “*trajtim çnjerëzor*”, “*trajtim poshtërues*”, “*ndryshim i intensitetit të vuajtjes së shkaktuar*”;

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, por në një vendim, gjyqtarja analizon konfliktin “*në dukje*” të neneve 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal në raport me njëri tjetrin si dhe me rrethanën cilësuese të veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, në analizës së të cilave gjyqtarja ka arritur në konkluzionin se zbatimi i këtyre bëhet njëkohësisht.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, duke evidentuar edhe konfliktin “*në dukje*” të normave, në rastet kur ka qenë e nevojshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

²²Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016

²³Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016

²⁴Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016

²⁵Vendimi nr. 42, datë 04.04.2016

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : *“..Në 4 dosjet civile të vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, evidenton natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente. Në çdo rast vihet re citimi i dispozitave ligjore procedurale dhe materiale penale dhe civile, të aplikueshme në zgjidhjen e çështjes. Në 2 dokumentet ligjore të paraqitura dhe në dosjen penale të vëzhguar gjyqtarja kualifikon drejt dhe saktë veprën penale si dhe merr në shqyrtim parashikimet e ligjit procedural penale për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike.Vihet re se gjyqtarja {...} përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës : parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës (dosja 3.4.5); parimi se çdo dyshim çmohet në favor të të pandehurit (dokumenti 1). madje parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturve gjyqtarja i referohet edhe gjatë seancës gjyqësore në arsyetimin e vendimit të ndërmjetëm për caktim psikologu si dhe detyrat e përcaktuara ndaj tij në funksion të zgjidhjes së çështjes (dosja 3 dhe 5).Në funksion të zbatimit të ligjit gjyqtarja përdor referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 2/20003 mbi aplikimin e gjyqimit të shkurtuar(dokumenti 1 dhe 2), në vendimin nr. 2 datë 06.02.2009 mbi bashkimin e dënimeve (dokumenti 2), vendimi nr. 1/2006 mbi përkufizimin e termit “armë”, vendimin unifikues nr.1/2005 të Gjykatës së Lartë i cili trajton dallimet midis veprave penale të vetëgjyqësise dhe shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie...vendimi unifikues nr. 4/2001 mbi format e bashkëpunimit (dokumenti 3). gjyqtarja gjatë arsyetimit të vendimeve referon dhe në akte ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar si Konventa e K.E “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” lidhur me elementet e trafikimit sipas K.P (dokumenti 1), Konventën Unike për Barnat Narkotike dhe Psikotrope mbi përfshirjen e “heroinës “si lëndë narkotike (dokumenti 2), Konventën kuadër të Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Konventa e Palermos) mbi përkufizimin e termit “grup i strukturuar” (dokumenti 2). Në një prej dokumenteve të paraqitura vihet re një analizë e hollësishme dhe e veçantë kushtuar rrethanës rënduese të provuar në gjykim “akti çnjerëzor dhe poshtëruës” si dhe referencat e Konventën kundër Torturës e OKB ratifikuar me ligj, Konventën Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës”, Kushtetutën e R. Sh, jurisprudenca e Gj. K (vendimi nr.3, datë*

11.02.2004) dhe ajo e GJEDNJ rreth definicionit të këtij termi ..(dokumenti 3)..Një rëndësi e veçantë në çështjet penale i kushtohet vlerësimit të provave referuar nenit 152 të K.Pr.P.)... ”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Normat ligjore procedurale dhe materiale, identifikohen dhe, sipas rastit aplikohen drejtpërdrejt mbi faktin, ose interpretohen dhe më pas aplikohen mbi faktin konkret, në shërbim të konkluzionit të arritur nga gjyqtarja në lidhje me zbatimin e tyre. Në vendimet e analizuara, ka një ndryshim thelbësor mbi mënyrën dhe masën e interpretimit të normave ligjore në raport me kategorinë e çështjeve (civile-familjare dhe penale) dhe për këtë arsye, burimet e vlerësimit, për efekt të matjes së këtij treguesi, do të analizohen me vete.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet civile-familjare: Përgjithësisht në vendimet e analizuara, normat ligjore të Kodit të Familjes apo ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, citohen ose referohen, duke u zbatuar drejtpërdrejt mbi faktet, pa u shoqëruar me një interpretim të pavarur të tyre. Kryesisht, nenet përkatëse të Kodit të Familjes janë referuar dhe zbatuar drejtpërdrejt, duke mbështetur konkluzionin e arritur nga gjyqtarja në lidhje me faktin, pa iu nënshtruar analizës ligjore të tyre.

Në të gjitha vendimet civile burim vlerësimi, posaçërisht në ato me objekt “Zgjidhje martesë”, gjyqtarja ka analizuar vetëm kuptimin e nenit 132 të Kodit të Familjes lidhur me kushtet që duhet të plotësohen për të kërkuar zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, dhe nenit 158/1 të K.F lidhur me kriteret që merren në konsideratë në përcaktimin e detyrimit për ushqim të prindit ndaj fëmijës së mitur²⁶.

Në vendimet penale të analizuara, ndyshe nga ato civile, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të K.Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, posaçërisht (i) formën e kryerjes së veprës, (ii) qëllimin kur ai përbën element të domosdoshëm për ekzistencën figurës së veprës penale, (iii) rrethanat cilësuese të tilla si kryerja e veprës penale më shumë se një herë ose në bashkëpunim, (iv) kuptimin dhe zbatimin e neneve të pjesës së përgjithshme të tilla si bashkëpunimi, format e veçanta të bashkëpunimit, kriteret e përcaktimit të llojit dhe masës së dënimit, etj. Analiza ligjore në nivel teorik, shoqërohet menjëherë me aplikimin mbi elementët të faktit të provuar në gjykim, dhe më pas me konkluzionin e arritur mbi kuptimin e ligjit dhe zbatimin e tij mbi faktin konkret.

Dispozitat e Kodit Penal (të pjesës së posaçme) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqendruar më tepër në anën objektive të veprave penale për të cilat procedohet, duke i analizuar në disa raste, në raporte krahasimore me njëra tjetrën, me qëllim cilësimin e saktë juridik të faktit penal. *Konkretisht :*

➤ Në vendimin nr. 45, datë 06.04.2016 interpreton nenin 109/b pg 1 të Kodit Penal, duke i kushtuar rëndësi kryesisht elementeve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, për të evidentuar faktin se vepra penale quhet e kryer pavarësisht faktit nëse ka ardhur ose jo pasoja, konceptin e kanosjes serioze, formën e dhunës, dhe qëllimin e veprës penale si element i domosdoshëm.

➤ Në vendimin nr. 22, datë 03.03.2016 gjyqtarja interpreton nenin 110/a pg 4 të K.P duke u ndalur në analizën ligjore të elementëve të anës objektive të veprës penale, forma e kryerjes së saj (rekrutimi me

²⁶(vendimi nr. 515, datë 17.03.2014, nr. 1748, datë 09.12.2014, nr. 476, datë 10.03.2014, nr. 2521, datë 19.12.2013, nr.29, datë 12.01.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan)

qëllim shfrytëzim prostitucioni), qëllimin e veprës (përfitimin material). Interpretimi i këtij neni, në lidhje me njërin nga faktet penale, ka sjellë vlerësimin e ndryshëm të gjykatës për kualifikimin ligjor të tij duke iu referuar figurës së posaçme të veprës penale që lidhet me trafikimin e të miturve (neni 128/b/3), në raport me njërin prej viktimave të trafikuar. Pas ndryshimit të kualifikimit gjyqtarja interpreton të katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 128/b/3, duke u ndaluar në të gjithë aspektet e anës objektive dhe subjektive të kësaj vepre, posaçërisht tek forma e kryerjes së saj dhe qëllimi. Po në këtë vendim, interpretohet neni 114/2 i Kodit Penal, duke u ndalur në të gjithë elementet e figurës së veprës penale si dhe në analizën e natyrës së kësaj vepre, në lidhje me kualifikimin e krimit si krim vazhdues. Këtij elementi gjyqtarja i kushton një rëndësi të posaçme duke interpretuar në nivel abstrakt dhe duke e përjashtuar interpretimin me faktet e çështjes dhe veprimet e të pandehurve, në shërbim të konkluzionit të arritur prej saj se fakti penal konkret nuk duhet të cilësohet si i kryer në rrethanën cilësuese “më shumë se një herë”, por si krim vazhdues.

➤ Në vendimin nr. 42, datë 04.04.2016 gjyqtarja interpreton elementët e figurës së veprës penale të trafikimit të narkotikeve, të kryer në rrethanat cilësuese (më shumë se një herë), duke u ndaluar në mënyrë të veçantë në interpretimin e ligjit sa i përket formës së kryerjes së veprës dhe qëllimit të saj (përfitimit material). Po në këtë vendim gjyqtarja interpreton nenin 333/a në lidhje me veprën penale të grupit të strukturuar kriminal, duke bërë fillimisht një analizë në nivel teorik lidhur me format e veçanta të bashkëpunimit sipas kuptimit të neneve 25 dhe 28 të Kodit Penal, së bashku me dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar. Po në këtë vendim, gjyqtarja ndalet në analizën krahasuese të elementeve të veprave penale të parashikuar nga nenit 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal, për të konkluduar se këto dy nene zbatohen njëkohësisht, interpretim ky i cili mbështetet edhe me qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 200, datë 12.06.2013.

➤ Në vendimin nr. 107, datë 14.09.2016, gjyqtarja interpreton, para aplikimit mbi faktet e provuara në gjykim, nenin 109/b/2 duke u ndalur në mënyrë të veçantë në elementet thelbësore për ekzistencën e kësaj figure të veprës penale (shtrëngimi me anë të dhunës dhe përfitimi i padrejtë). Interpretimi abstrakt i elementëve të kësaj figure të veprës penale, bëhet edhe në dimension krahasues me elementet e veprës penale të vetëgjyqësisë parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal si dhe mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur nga Gj. Lartë në vendimin unifikues nr. 1, datë 25.03.2005. Po në këtë vendim, gjyqtarja ndalet në interpretimin e elementeve cilësues të veprës penale sipas pg 2 të nenit 109/b, duke analizuar dhe dhënë kuptimin e termave « akt çnjerëzor » dhe « trajtim poshtërues », referuar nenit përkatës të Kodit Penal, Konventës së OKB kundër torturës, nenit 25 të Kushtetutës, vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 11.02.2004 si dhe jurisprudencës të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Krahas interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi edhe *interpretimit të dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal* në lidhje me (i) bashkëpunimin si rrethanë cilësuese ose rënduese, duke u ndalur posaçërisht në elementet e anës objektive dhe subjektive të tij si dhe natyrën e marrëveshjes për kryerjen e veprës penale, (ii) formën e veçantë të bashkëpunimit në formën e grupit të strukturuar kriminal, (iii) zbatimin e ligjit penal favorizues (iv) interpretimin e nenit 55 të Kodit Penal lidhur me bashkimin e dënimeve, interpretim të cilin gjyqtarja e shoqëron edhe me argumentimin e mënyrës së bashkimit të dënimeve të aplikuar prej saj në rastin konkret, (v) interpretimin e qëllimit të dënimit penal dhe vënien e theksit tek rehabilitimi si qëllim primar, posaçërisht në

rastin e të pandehurve të mitur²⁷(vi) interpretimin e kuptimit të alternativës së dënimit me burgim të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, kushtet ligjore të aplikimit të saj, qëllimit të aplikimit të një dënimi alternativ, natyrën e masave dhe detyrimeve të të dënuarit gjatë kohës së provës sipas parashikimeve të nenit 60 të Kodit Penal dhe qëllimin e tyre, duke sjellë në mbështetje të interpretimit të këtyre neneve edhe argumente në lidhje me standardet ndërkombëtare të cilat klasifikojnë burgimin si dënim i cili duhet të kufizohet rreptësisht dhe të zbatohet vetëm në rastet kut çdo formë tjetër dënimi është e papërshtatshme²⁸.

-Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale:

Gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi vetëm në vendimet penale të analizuara, interpretimit të normës, jo vetëm përsa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, por edhe zgjidhjes së situatave procedurale, në rastin e kërtimeve të palëve, mënyrës së marrjes dhe vlerësimit të provave, etj.

Konkretisht gjyqtarja interpreton:

- (i) nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar dhe vlerësimin e gjykatës në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të këtij neni, me pasojë pranimin e kërkesës²⁹;
- (ii) nenin 152 të K.Pr.P në lidhje me vlerësimin dhe çmuarjen e provave dhe, mënyrë specifike në një rast, ky nen është analizuar në drejtim të nevojës për konfirmim të fakteve dhe rrethanave që përmbajnë deklaratimet e të dëmtuarit, me prova të tjera direkte ose indirekte³⁰;
- (iii) nenin 16 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e lidhjes mes të pandehurit dhe të dëmtuarës si “krushqi e afërt”, në shërbim të konkluzionit në lidhje me mungesën e elementit cilësues të veprës penale të parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal³¹;
- (iv) nenin 208/a të K.Pr.P në lidhje me kushtet ligjore të lejimit për marrjen dhe sekuestrumin e të dhënave kompjuterike³²;
- (v) nenin 375 të K.Pr.P në lidhje me ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal, duke analizuar kushtet e aplikimit të këtij neni në rastin e procedimit me gjykim të shkurtuar³³;
- (vi) nenin 193/5 të K.Pr.P në lidhje me efektet e vendimit të formës së prerë ndaj bashkë të pandehurve të tjerë sa i përket vlerës së tij në gjykim si dhe efektet e këtij vendimi në raport me ekzistencën e faktit penal³⁴.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, gjyqtarja ka respektuar elementet e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtat e palëve, duke iu krijuar atyre mundësi të marrin pjesë personalisht në gjykim, të dëgjohen, të kërkojnë marrjen e provave, të debatojnë mbi provat, të kenë asistencën e mbrojtësit dhe të psikologut në rastin e të pandehurve të mitur, etj.

Në çështjet civile-familjare të analizuara, gjyqtarja referon parimin e interesit më të lartë të fëmijës në lidhje përcaktimin se me cilin prind do të lihen për rrije dhe edukim fëmijët e mitur si

²⁷Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016.

²⁸ Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

²⁹ Vendimi nr. 109, datë 10.02.2014 i Gj.Rr.Gj.Elbasan, vendimet nr. 45, datë 06.04.2016, nr. 22, datë 03.03.2016, nr. 42, datë 04.04.2016 të Gj.Sh.P për Krime të Rënda.

³⁰ Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

³¹ Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

³² Vendimi nr.210, datë 19.12.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

³³Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

³⁴Vendimi nr. 42, datë 04.04.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

dhe raportet e tij me prindin tjetër. Përveç këtij parimi i cili është referuar, por pa u shoqëruar me një interpretim dhe zbatim të tij mbi rrethanat e çështjeve konkrete në raport me të, nuk rezulton të jenë referuar apo zbatuar parime të tjera të se drejtës, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve civile të trajtuara.

Në çështjet penale, rezulton të jetë zbatuar (i) parimi zbatimin e ligjit penal favorizues (neni 3 i Kodit Penal) si përsa i përket zbatimit të dispozitës favorizuese të pjesës së posaçme të Kodit Penal ashtu edhe përsa i përket zbatimit të ligjit penal favorizues në lidhje me bashkimin e dënimeve, për shkak se neni 55 i Kodit Penal, pas ndryshimeve që ka pësuar, është vlerësuar në një rast nga gjyqtarja, se nuk duhet të zbatohet, pasi formulimi i tij në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë më favorizues për të pandehurin³⁵; (ii) parimi procedural i mos rëndimit të pozitës së të pandehurit gjatë rigjyimit, i cili ka ardhur si pasojë e kërkesës së tij për rishikimin e vendimit. Zbatimi i këtij parimi të referuar nga gjyqtarja në arsyetim, mbështetet edhe me referimin e qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 2, datë 06.02.2009.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante:

Në vendimet civile burim vlerësimi si dhe në vendimin penal të kategorisë kërkesë penale të fazës së hetimit paraprak, nuk evidentohet referimi apo përdorimi i jurisprudencës relevante.

Në vendimet penale të themelit, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin e ligjit dhe aplikimin e tij mbi faktet, posaçërisht në lidhje me:

- (i) aplikimin e procedimit me gjykim të shkurtuar, duke referuar, krahas bazës ligjore dhe vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003³⁶;
- (ii) bashkëpunimin në kryerjes ne veprës penale, marrëveshjen si dhe aspektet e anës objektive dhe subjektive të që duhet te ekzistojnë për të vlerësuar ekzistencën e saj mes të pandehurve, duke referuar në vendimin unifikues nr. 4, datë 15.04.2011³⁷,
- (iii) vendimin unifikues nr. 1, datë 12.03.2002 dhe qëndrimin e Kolegjit Penal në vendimin nr. 226/2010;
- (iv) parimin e mos rëndimit të pozitës së të pandehurit në rastin kur çështja i nënshtrohet rishqyrtimit për shkak të kërkesës së të pandehurit për rishikim të vendimit, duke u bazuar ky konkluzion në qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 2, datë 06.02.2009)³⁸;
- (v) elementët e veprës penale të shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, duke referuar në konkluzionet unifikuese të vendimit nr. 1, datë 25.03.2005 të Gjykatës së Lartë;
- (vi) kuptimin e termave “trajtim çnjerëzor dhe poshtërues” në kuptim të nenit 109/b paragrafi i dytë i Kodit Penal, duke referuar në lidhje me këtë aspekt vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 3, datë 11.02.2004 si dhe qëndrimet e GJEDNJ në çështjen *Arsoy kundër Turqisë*, *Rannien kundër Francës*, etj.

³⁵ Vendimi nr. 22, datë 03.03.2016.

³⁶ Vendimi nr. 45, datë 06.04.201, nr. 22, datë 03.03.2016 dhe nr. 42, datë 04.04.2016.

³⁷ Vendimi nr. 45, datë 06.04.2016 dhe vendimi nr. 22, datë 03.03.2016.

³⁸ Vendimi nr. 42, datë 04.04.2016.

(vii) elementët e anës objektive dhe elementët cilësues të veprës penale të parashikuar nga neni 109/b i K.Penal, përballë pretendimit se veprimet e të pandehurve përmbajnë elementët e veprës penale të vetëgjyqësisë. Pas përballjes dhe analizës abstrakte të elementëve të këtyre dy veprave, referohet dhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me këto dy vepra në vendimin nr. 1/2005³⁹.

Në tërësi, në vendimet përfundimtare penale të vëzhguara, interpretimi i dispozitave ligjore, përveç analizës abstrakte të kuptimit të tyre, pasurohet me referimin dhe analizën e dispozitave të akteve ndërkombëtare që gjejnë zbatim si dhe me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Kolegjit Penal të GJ.L, praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencën relevante të GJEDNJ. Ndërsa në vendimet civile të analizuara, interpretimi i dispozitave ligjore është i kufizuar, nuk rezulton të ketë një interpretim të pavarur të tyre, përveç interpretimit të nenit 132 të Kodit të Familjes, pasi dispozitat ligjore referohen, citohen dhe aplikon drejtpërdrejt mbi faktin, pa dhënë arsye për mënyrën e aplikimit të tyre.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material penal, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësorë unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo lloj analize nuk ka të njejtën shkallë kujdesi në çështjet civile, ku gjyqtarja kryesisht referon dhe aplikon drejtpërdrejt ligjin mbi faktet e provuara në gjykim, duke i lidhur ato me konkluzionet e arritura, por nuk ndalet në interpretimin e ligjit dhe dhënien e arsyeve konkrete për mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarës në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë : qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga

³⁹ Vendimi nr. 107, datë 14.09.2016.

përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :” *Subjekti i rivlerësimit Deniala[...] ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi. 2 nga 3 vendimet penale të themelit janë organizuar sipas një strukture ku vendimi ndahet në pjesë, në nënndarje : pretendimet në gjykim, rrethanat e faktit, arsyetimi ligjor (doc 1 dhe 2). Në dokumentin 1 strukturimi i vendimit për çdo të pandehur nga njëra anë e bën të kuptueshëm atë çka ka vlerësuar dhe konkluduar gjykata në atë pjesë, ndërsa e parë në tërësi me ndarjet, apo nënndarjet e tjera krijon vështirësi për të kuptuar logjikën në tërësi. Listohet me paragrafë çdo provë e marrë në shqyrtim, çfarë e ngarkon leximin e këtij vendimi, i cili paraqitet voluminoz. Në dokumentin 3 gjyqtarja përdor sërish metodën e strukturimit të vendimit për çdo çështje të marrë në analizë, vendim i cili paraqitet gjithashtu voluminoz kjo edhe për shkak të numrit të të pandehurve. Gjyqtarja tregon kujdes për të marrë në analizë çdo episod të veprës penale duke çmuar dhe vlerësuar provat respektive për secilin të pandehur në këndvështrim të parashikimeve ligjore si dhe praktikës unifikuese për rastin në gjykim. Karakteristikë e arsyetimit në paragrafë me vete për caktimin e dënimit, provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore.....”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjuha e përdorur nga gjyqtarja në komunikimin me palët gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara dhe vendimet përfundimtare, është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë për palët në proces, si dhe për lexuesin e akteve.

Janë përdorur përgjithësisht të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte.

Referimi i parimeve të së drejtës në gjuhën latine, është shoqëruar me dhënien e kuptimit të tyre në gjuhën shqipe, duke mos krijuar paqartësi lidhur me kuptimin e tyre.

Në të gjitha vendimet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë përdorur terma teknikë apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren, përveç termave të referuar në përshkrimin apo citimin e përmbajtjes së provave të tilla siç janë aktet e ekspertimit, terma të cilët janë të njohur dhe kuptimi i tyre është i qartë nga konteksti apo lloji i provës në të cilën janë fiksuar këto terma.

Gjyqtarja përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të cilat janë të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit janë të

lidhura me njëra tjetrën edhe pse disa herë krijojnë shkëputje të logjikës së arsytimit, brenda së njëjtës nëndarje të arsytimit të vendimit apo në gjithë vendimin në tërësi.

Por mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsytimin e vendimeve, kryesisht në çështjet penale me fakt kompleks dhe disa të pandehur, vështirëson kuptueshmërinë e arsytimit të vendimit, sikundër është konstatuar edhe në raportin analitik të rivlerësimit. Rrjedha logjike e arsytimit ndërpritet herë pas herë me rikthim në fakte apo argumenta të lexuara më parë, me përsëritje të panevojshme që zbehin cilësinë e analizës, edhe pse ajo ekziston.

KONKLUSIONE:

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, gjyqtarja tregon kujdes për pasqyrimin qartë dhe saktë të fakteve, provave, dispozitave ligjore si dhe interpretimin e tyre mbi faktet e provuara. E njëjta shkallë kujdesi nuk evidentohet në drejtim të koncizitetit dhe lehtësisë së të kuptuarit të komponentit analitik. Për këtë arsye, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “mbi mesataren” në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Mbi mesatare” duke u pikëzuar me 12 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në Raportin analitik të rivlerësimit lidhur me këtë tregues, konkludohet se :” *Subjekti i rivlerësimit Deniala{...} ka aftësi në arsytimin ligjor me cilësi. 2 nga 3 vendimet penale të themelit janë organizuar sipas një strukture ku vendimi ndahet në pjesë, në nëndarje : pretendimet në gjykim, rrethanat e faktit, arsytimi ligjor (doc 1 dhe 2). Në dokumentin 1 strukturimi i vendimit për çdo të pandehur nga njëra anë e bën të kuptueshëm atë çka ka vlerësuar dhe konkluduar gjykata në atë pjesë, ndërsa e parë në tërësi me ndarjet, apo nëndarjet e tjera krijon vështirësi për të kuptuar logjikën në tërësi.Në dokumentin 3 gjyqtarja përdor sërish metodën e strukturimit të vendimit për çdo çështje të marrë në analizë, vendim i cili paraqitet gjithashtu voluminoz kjo edhe për shkak të numrit të të pandehurve.. . Në 5 dosjet e vëzhguara vendimi përfundimtar është gjithashtu i organizuar me strukture ku vendimi ndahet në pjesë : rrethanat e çështjes, arsytimi ligjor...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Vendimet përfundimtare të gjyqtarës, referuar kategorisë së çështjes dhe kompleksitetit të përmbajtjes së vendimit, ndjekin përgjithësisht strukturë të njëjtë brenda së njëjtës kategori. Të gjitha vendimet, civile dhe penale, përmbajnë elementët e domosdoshëm të vendimit gjyqësor sipas parashikimeve të nenit 310 të K.Pr.C dhe nenit 383 të K.Pr.P.

Vendimet civile-familjare, në pjesën e arsytimit të vendimit, janë të strukturuar në nënndarje të cilat janë titulluar sipas përmbajtjes së tyre, duke filluar me “rrethanat e çështjes” dhe “arsyetimin ligjor të gjykatës”, pjesë në të cilën gjyqtarja ka veçuar nëpërmjet një fjalie hyrëse, elementët e vlerësuar sipas kërkimeve objekt padie, duke orientuar lexuesin për përmbajtjen e arsytimit në vijim të çdo pjese. Në vendimin për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, struktura është e njëjtë, duke paraqitur specifika vetëm në pjesën e dispozitivit, ku urdhërimet e gjykatës i referohen parashikimeve të ligjit të posaçëm për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

Në çështjet penale, në varësi të objektit të çështjes apo kompleksitetit të saj, vendimet përfundimtare të vëzhguara janë të organizuara sipas një strukture përgjithësisht të njëjtë, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit. Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë ose objektin e kërkesës dhe nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të plotë ose të përmbledhur.

Pjesa përshkruese- arsyetuese e vendimeve gjithashtu ndjek një strukturë të mirë përcaktuar e cila është e dukshme edhe në aspektin formal, ku secila pjesë titullohet në përputhje me përmbajtjen e saj. Organizimi i pjesëve të arsytimit të vendimit ka ndjekur të njëjtën strukturë, duke filluar me paraqitjen rrethanave të çështjes në rend kronologjik, paraqitjen e faktit penal të provuar gjatë gjykimit, paraqitjen e pretendimeve të palëve gjatë gjykimit dhe në diskutimin përfundimtar si dhe, në rastet kur është disponuar me vendim për këto kërkesa gjatë gjykimit, gjyqtarja evidenton vendimin e ndërmjetëm dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi. Më pas arsyetimi vijon me nënndarjen e titulluar “Arsyetimi ligjor”, nënndarje e cila është e organizuar në disa nën pjesë të tjera, sipas përmbajtjes, dhe që përmban analizën e provave e cila është bërë në disa raste edhe me vete për secilin fakt penal ose secilin të pandehur kur rastet janë komplekse dhe përmbajnë disa fakte penale në të njëjtën çështje. Në këtë pjesë gjithashtu gjendet analiza ligjore e dispozitave të zbatueshme, analiza ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale si dhe caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, pjesë në fund të së cilës evidentohen edhe disponimet lidhur me kërkesën për disponimin mbi provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore.

Në disa nga vendimet penale të analizuara, referuar kompleksitetit të gjykimit, gjyqtarja, ka organizuar arsyetimin e vendimit duke evidentuar edhe disa nënndarje të tjera si për të përshkruar veprimet hetimore të kryerja në një pjesë me vete, ecurinë procedurale të çështjes duke veçuar procedurën e ndjekur për njoftimin e të pandehurit, kërkesat paraprake të palëve dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës lidhur me to,⁴⁰ për të vijuar me pas me rrethanat e faktit penal objekt gjykimi.

⁴⁰ Vendimi nr. 107, datë 14.09.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

E gjithë përmbajtja e vendimit është e ndarë në paragrafë, të cilat në shumicën e vendimeve përmbajnë edhe numërtim dhe lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri të arsyetimit. Përdorimi i titujve dhe pikave referuese mundëson lexim të organizuar.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me pranimin e padisë, disponimin për objektin e saj dhe pasojat e zgjidhjes së martesës në rastet kur objekti është i tillë, disponimet për detyrimet ligjore lidhur me regjistrimin e vendimit në ZGJC, lidhur me pasojat e zgjidhjes së martesës në raport me fëmijët e mitur, cilësinë e tij si titull ekzekutiv, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit. Në vendimin për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, dispozitivi përmban të gjitha urdhërimet dhe disponimet sipas parashikimeve të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Në vendimet penale dispozitivi përmban disponimin për fajësinë e të pandehurve, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, bashkimin e dënimeve, uljen e dënimit për shkak të gjyqimit të shkurtuar kur është rasti, kohën e fillimit të llogaritjes së dënimit, institucionin e vuajtjes së tij, disponimin e plotë për provat materiale, shpenzimet procedurale si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecuresë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :” *Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi.. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja*

midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Ajo tregon normën ligjore që zbatohet për faktin e mosmarrëveshjes të përcaktuar sipas provave të shqyrtuara...nga pikëpamja formale vendimet përfundimtare të saj plotësojnë sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penale apo kërkesat e legjislacionit procedural civil. gjyqtarja bën pjesë të arsytimit edhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës mbi kërkesat e palëve mbi aplikimin e gjykimit të shkurtuar apo kërkesave të tjera procedurale, apo mënyrën e njoftimit të palëve (dokumenti 3).Karakteristikë e gjyqtarës në gjykimin e çështjeve me të mitur është përcaktimi me vendim të ndërmjetëm i detyrave shumë të qarta për psikologun duke orientuar atë për tu shprehur mbi gjendjen, marrëdhëniet, cilësitë dhe aftësitë e palëve ndërgjyqëse të cilat duhet të vëzhgohen duke patur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Vihet re se gjyqtarja tregon kujdes për të garantuar të drejtën e fëmijës për të qëndruar me secilin prind në pushimet verore, dimërore si dhe në pjesën tjetër të vitit...Gjithashtu në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme duke cituar në çdo rast bazën ligjore përkatëse... Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me objektin e mosmarrëveshjes”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Burimet e vlerësimit, referuar kategorisë dhe objektit të mosmarrëveshjes apo çështjes së trajtuar, lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, paraqesin karakteritika të ndryshme sa i përket vendimeve civile-familjare dhe atyre penale.

Në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja tregon kujdes në analizimin e plotë dhe të qartë të faktit penal, analizon në mënyrë të detajuar dhe logjike provat, duke i integruar ato me analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, si në lidhje me aspektet procedurale ashtu edhe në raport me kualifikimin ligjor të faktit penal. Karakteristikë e gjyqtarës është analiza e qartë dhe e plotë e faktit, shoqëruar me analizën e plotë të provave dhe veçanërisht përcaktimin e vlerës provuese të tyre, në veçanti dhe në tërësi. Në rastet komplekse, gjyqtarja grupon dhe analizon së bashku provat në raport me faktin penal, duke evidentuar në përfundim të analizës së tyre, konkluzionet lidhur me faktet që kanë rezultuar të provuara. Karakteristikë e gjyqtarës është integrimi në mënyrë logjike dhe në vendin e duhur i dispozitave ligjore të zbatueshme. Në vijim të analizës gjyqtarja interpreton dispozitat mbi faktin konkret dhe vijon me konkluzionin e arritur. Midis analizës së faktit, interpretimit dhe zbatimit të ligjit, ka rrjedhë logjike.

Në çështjet me disa të pandehurit, gjyqtarja ndan dhe analizon në mënyrë specifike faktin, provat me njëra tjetrën, duke individualizuar rolin e secilit të pandehur në kryerjen e veprës. Analiza është gjithëpërfshirëse në rastet e vlerësimit të ndryshëm të gjykatës lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, kryesisht ose duke iu përgjigjur pretendimeve të mbrojtjes së të pandehurit për ndryshimin e kualifikimit.

Në secilin vendim penal të analizuar, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), analiza dhe arsyetimi shtjellohen në mënyrë logjike, duke integruar interpretimin dhe analizën ligjore të elementëve të veprës penale, koncepteve dhe instituteve, me analizën e fakteve të provuara në gjykim. Paraqitja dhe analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale si dhe autorësinë, si në pjesën ku fakti paraqitet në një nënndarje të veçantë, ashtu edhe në pjesën e arsytimit ligjor të gjykatës ku ai

integrohet në mënyrë të natyrshme me analizën ligjore, e bën atë një analizë të plotë dhe të gjithanshme.

Karakteristikë e gjyqtarës është analiza më e detajuar e fakteve esenciale të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim në lidhje me elementë të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, autorësinë e të pandehurit dhe rolin e tij, paraqitjen dhe analizën e plotë të provave në lidhje me secilin fakt. Në cilësinë e analizës spikat lidhja në mënyrë të drejtpërdrejtë e faktit/fakteve të provuara, me elementët e figurës së veprës penale, të analizuar më parë, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë.

Interpretimi ligjor i dispozitave dhe më pas analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale në raport me faktet e provuara në gjykim, e bën arsyetimin e vendimeve cilësor dhe përmbush kërkesat e një arsyetimi logjik, përfshirë edhe zgjidhjen e situatave procedurale.

Ne vendimet civile të analizuar, nuk evidentohet e njëjta shkallë analize dhe argumentimi logjik. Komponenti analitik bazohet kryesisht në konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, pa analizë të konkretizuar, pse fakte të caktuara çojnë në këtë përfundim ligjor. Edhe pse konceptet ligjore evidentohen, ato jo gjithmonë analizohen në raport me faktet e provuara e marrëdhënien shkak-pasojë. Gjyqtarja bën një analizë të përmbledhur dhe të përgjithshme lidhur me arsyet e vlerësimit të saj për kërkimet objekt padie në raport me ligjin e zbatueshëm, por kjo analizë jo gjithmonë është e konkretizuar në raport me faktet e provuara në gjykim. Përgjithësisht, pa u individualizuar rasti konkret, në arsyetimin e vendimeve civile referohen terma të përgjithshëm lidhur me vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në disponimin për lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim, kriteret për caktimin e detyrimit për ushqim, apo masat mbrojtëse të urdhëruara në rastin e urdhrin të mbrojtjes në raport me situatën dhe kushtet konkrete të jetesës së palëve, etj, .

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në vendimet penale të analizuar, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar fillimisht në pjesën hyrëse të vendimit ose, në disa raste komplekse edhe në përmbajtje të arsyetimit, në një nënndarje të veçantë, dhe më pas analizohen dhe merren në shqyrtim në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin konkret (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal, për llojin dhe masën e dënimit, etj). Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, jo në një pjesë të veçantë të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar dhe analizuar plotësisht, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit të vendimit.

Në vendimet civile të analizuar, pretendimet e palëve janë integruar në përmbajtje të vendimit dhe kanë marrë përgjigje në arsyetim, por jo në çdo rast këto pretendime, të cilat kanë qenë thelbësore për zgjidhjen e çështjes, janë analizuar në mënyrë specifike dhe të plotë. Në një rast, lidhur me kërkimin e paditësit për lënien e njërit nga fëmijët e mitur për rritje dhe edukim, gjyqtarja argumenton në mënyrë të përgjithshme shkaqet që kanë ndikuar në vlerësimin e saj për lënien e të dy fëmijëve për rritje dhe edukim nënës së paditur, por nuk ka bërë pjesë të arsyetimit

të vendimit, analizën e pretendimit të paditësit, edhe pse pretendimi i tij lidhet me një kërkim thelbësor objekt-padie.⁴¹

KONKLUSIONE:

Në tërësi, në vendimet penale të analizuara, analiza ligjore si në lidhje me aspekte procedurale të zhvillimit të gjyqimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe në analizën ligjore të veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, është një analizë e plotë, e thellë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Ajo përmbush në çdo rast jo vetëm standardet e procesit të rregullt ligjor, por pasurohet edhe me interpretim të pavarur të ligjit si dhe qëndrime të praktikës gjyqësore, duke u integruar në mënyrë të natyrshme dhe në masën e duhur në arsyetim. Ndikim cilësor në arsyetimin e vendimeve penale është edhe referimi dhe interpretimi i normave të akteve të së drejtës ndërkombëtare, për të mbështetur interpretimin mbi kuptimin e dispozitave të ndryshme të legjislationit vendas dhe për të mbështetur argumentet lidhur me konkluzionin për zbatimin e tyre mbi faktin konkret. Ndërkohë, në vendimet civile të analizuara, gjyqtarja nuk ka treguar të njëjtën shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Procesi analitik i vlerësimit të provave, analizës së marrëdhënies shkak-pasojë si dhe zbatimit të dispozitave ligjore mbi faktet e provuara, në çështjet civile, evidenton dukshëm një shkallë të ndryshme aftësie të gjyqtarës në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “mbi mesatare” duke e pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarës në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shumë mirë	87

⁴¹ Vendimi nr. 515, datë 17.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, analizuar së bashku me treguesin që lidhet me respektimin e standardit minimal kohor, konkludohet se :”Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtare {...} ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (dosja 1) deri në 3 muaj dhe 24 ditë (dosja 4). Çështja që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë çështje familjare me objekt “ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor” e cila është shqyrtuar në 5 seanca (3 përgatitore dhe 2 gjyqësore), nga të cilat 2 janë seanca joproduktive dhe kanë dështuar :i) mos marrjen dijeni të të paditurit dhe ii)me kërkesë të paditëses për shkaqe objektive. Asnjë seancë nuk rezulton të ketë dështuar për mos menaxhim të procesit nga ana e gjyqtarës. Çështja që ka patur kohëzgjatjen me të ulët 1 ditë ka qenë kërkesë penale e ngutshme me objekt “sekuestrim dhe marrje e të dhënave kompjuterike”, e gjykuar dhe përfunduar me 1 seancë gjyqësore. Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 27 ditë (dosja 5), 2 muaj (dosja 3) dhe 2 muaj e 24 ditë (dosja 2). Kohëzgjatja e gjykimit tek të 5 dosjet e vëzhguara rezulton të jetë brenda afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve dhe afateve procedurale penale për gjykimin e kërkesave të ngutshme referuar nenit 208/a pg 2 të K.Pr.P. në 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit gjyqësor. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve nga gjyqtarja por i referohet kohës së regjistrimit të çështjes në gjykatën përkatëse. Nga analiza e tre dokumenteve ligjore është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 4 muaj e 21 ditë (dokumenti 2), 7 muaj e 28 ditë (dokumenti 1) dhe 11 muaj e 26 ditë (dokumenti 3). Kohëzgjatja e gjykimit tek të 3 dokumentet e paraqitura rezulton të jetë brenda afatit standard 12 mujor të përcaktuar nga Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve...”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, të cilat i përkasin kategorisë “penale themeli”, “familjare me palë kundërshtare” (zgjidhje martese, urdhër mbrojtje dhe padi për ndryshim të detyrimit ushqimor), dhe “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”.

Në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile nuk parashikohen afate ligjore për gjykimin e çështjeve penale të themelit dhe çështjet familjare me palë kundërshtare me objekt “zgjidhje martese” apo “ndryshim i masës së detyrimit ushqimor”. Ndërkohë për shqyrtimin e kërkesave të fazës së hetimeve paraprake si dhe për shqyrtimin e padive për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, në Kodin e Procedurës Penale si dhe në ligjin e posaçëm nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, parashikohen afate ligjore gjykimi.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se ligji ka parashikuar afate ligjore brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi, për çështjet si më poshtë:

- i) Për kërkesën penale të fazës së hetimit paraprak me objekt “sekuestrim dhe marrje e të dhënave kompjuterike”, neni 208/a pika 2 i K.Pr.P (sipas formulimit të dispozitës në kohën e zhvillimit të gjykimit) ka parashikuar shqyrtimin e menjëhershëm të kërkesës së prokurorit. Në rastin konkret, në çështjen që i përket vendimit nr. 210, datë 19.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kërkesa e prokurorisë është shqyrtuar dhe ka përfunduar të njëjtën ditë në të cilën çështja është regjistruar në gjykatë, duke respektuar afatin e shqyrtimit të saj, në mënyrë të menjëhershme, pasi ligji i kohës nuk përkufizonte në kohë “menjëhershmerinë e shqyrtimit”, duke përcaktuar një afat të përcaktuar në orë ose në ditë. Për këtë arsye, shqyrtimi i kërkesës për më pak se 1/ditë ose 24/orë, vlerësohet se përbën shqyrtim të menjëhershëm të saj në kuptim të ligjit procedural.
- ii) Për çështjet civile-familjare me objekt “Lëshim i urdhrit të mbrojtjes”, ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar (sipas formulimit të tij në kohën e zhvillimit të gjykimit në vitin 2014) në nenin 19, pika 2, shkronja “d” dhe nenin 20 të tij parashikonte afatin ligjor 20/ditor të gjykimit, nga data e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në çështjen që i përket vendimit nr. 82, datë 08.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, në kuadër të verifikimit të urdhrit të menjëhershëm të lëshuar me vendimin me datë 26.09.2014, rezulton se ka përfunduar për 13 ditë, brenda afatit ligjor 20 ditor. Në këtë çështje, sa i përket respektimit të afateve ligjore, lidhur me vendimin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, rezulton se çështja është shqyrtuar të njëjtën ditë të regjistrimit të saj në gjykatë, më datë 26.09.2014, duke respektuar afatin ligjor 48 orësh të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006.

Për sa më sipër, duke iu referuar dy çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore shqyrtimi, rezulton se këto afate janë respektuar nga ana e gjyqtarës duke përfunduar gjykimin brenda tyre.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor gjykimi, duke iu referuar dy çështjeve të analizuara më sipër në të cilat afati ligjor i gjyqimit është respektuar, aftësia e gjyqtarëve në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjyqimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se nga ana e gjyqtarëve janë respektuar standardet minimale kohore të gjyqimit, duke iu referuar të njëjtit konkluzion të cituar në treguesin më sipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjyqimit për çështjet me afat ligjor dhe standard minimal kohor është bërë së bashku në raport⁴².

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 9 çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afati ligjor gjykimi dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas Vendimit nr.261/2 të KLD-së. Duke iu referuar kategorisë së çështjeve, çështjet e analizuara i përkasin kategorisë “penale themeli” dhe “familjare me palë kundërshtarë”.

Për çështjet e kategorisë “penale themeli”, në vendimin nr. 261/2 parashikohet se gjykimi në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda duhet të gjykohe brenda standardit minimal kohor prej 12 muajsh ndërsa në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të zakonshëm, në varësi të

⁴²Shih konkluzionin e Raportit të KLGJ me nr. 3086/5 prot, datë 26.7.2019, faqe 32 dhe 33 e raportit, cituar në analizën e treguesit “Respektimi i afateve ligjore”, më sipër.

llojit të veprës (kundërvajtje ose krim) apo masës së dënimit (deri në 10 vjet apo mbi 10 vjet burgim) gjykimi duhet të përfundojë brenda 4, 9 ose 12 muajsh⁴³.

Sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit për pesë çështjet e kësaj kategorie, rezulton si më poshtë:

- i) Çështja që i përket vendimit nr. 109, datë 10.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është regjistruar dhe shortuar më datë 04.02.2014, pas pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të drejtpërdrejtë, dhe ka përfunduar më datë 10.02.2014, duke zgjatur gjykimi 6/ditë, brenda standardit minimal kohor 9 muaj të parashikuar në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve.
- ii) Çështja që i përket vendimit nr. 45, datë 06.04.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar më datë 01.03.2016 dhe shortuar më datë 03.03.2016. Gjykimi ka përfunduar më datë 06.04.2016, duke zgjatur 1 muaj e 3 ditë, brenda standardit minimal kohor 12/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- iii) Çështja që i përket vendimit nr. 22, datë 03.03.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar më datë 31.07.2015⁴⁴. Gjykimi ka përfunduar më datë 03.03.2016, duke zgjatur gjykimi 7 muaj e 3 ditë, brenda standardit minimal kohor 12/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- iv) Çështja që i përket vendimit nr. 42, datë 04.04.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar më datë 23.11.2015⁴⁵. Gjykimi ka përfunduar më datë 04.04.2016, duke zgjatur gjykimi 4 muaj e 11 ditë, brenda standardit minimal kohor 12/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- v) Çështja që i përket vendimit nr. 107, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar më datë 18.09.2015⁴⁶. Gjykimi ka përfunduar më datë 14.09.2016, duke zgjatur gjykimi 11 muaj e 26 ditë, brenda standardit minimal kohor 12/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.

Për çështjet e kategorisë “familjare me palë kundërshtare” në vendimin nr. 261/1 të viti 2010 të KLD-së, parashikohet standardi minimal kohor 4/muaj për përfundimin e gjykimit. Sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit për shtatë çështjet e kësaj kategorie, rezulton si më poshtë:

- vi) Çështja që i përket vendimit nr. 1734, datë 05.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është regjistruar dhe shortuar më datë 11.09.2014 dhe ka përfunduar më datë 05.12.2014, duke zgjatur gjykimi për 2 muaj e 24 ditë, brenda standardit minimal kohor 4/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- vii) Çështja që i përket vendimit nr. 1748, datë 09.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është regjistruar dhe shortuar më datë 09.10.2014 dhe ka përfunduar më datë

⁴³ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se :” *Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykrimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë: a. Gjykrimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm....f. Gjykrimet penale në gjykatën e shkallës së parë për krimet e rënda, jo më tej se 12 muaj.*”

⁴⁴ Nuk ka të dhëna për datën e shortimit të çështjes për shkak se i përket vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim.

⁴⁵ Nuk ka të dhëna për datën e shortimit të çështjes për shkak se i përket vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim.

⁴⁶ Nuk ka të dhëna për datën e shortimit të çështjes për shkak se i përket vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim.

- 09.12.2014, duke zgjatur gjykimi për 2 muaj, brenda standardit minimal kohor 4/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- viii) Çështja që i përket vendimit nr. 476, datë 10.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është shortuar më datë 14.11.2013 dhe ka përfunduar më datë 10.03.2014, duke zgjatur gjykimi për 3 muaj e 24 ditë, brenda standardit minimal kohor 4/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- ix) Çështja që i përket vendimit nr. 2521, datë 19.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është shortuar më datë 21.10.2013 dhe ka përfunduar më datë 19.12.2013, duke zgjatur gjykimi për 1 muaj e 27 ditë, brenda standardit minimal kohor 4/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- x) Çështja që i përket vendimit nr. 515, datë 17.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është shortuar më datë 21.11.2013 dhe ka përfunduar më datë 17.03.2014, duke zgjatur gjykimi për 3 muaj e 24 ditë, brenda standardit minimal kohor 4/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- xi) Çështja që i përket vendimit nr. 29, datë 12.01.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është shortuar më datë 23.10.2014 dhe ka përfunduar më datë 12.01.2015, duke zgjatur gjykimi për 2 muaj e 20 ditë, brenda standardit minimal kohor 4/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.
- xii) Çështja që i përket vendimit nr. 1411, datë 06.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është shortuar më datë 01.09.2014 dhe ka përfunduar më datë 06.10.2014, duke zgjatur gjykimi për 1 muaj e 5 ditë, brenda standardit minimal kohor 4/muaj të përcaktuar në aneksin I të vendimit të KLD nr. 261/2.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 12/çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore të cilat i përkasin dy kategorive, “penale krime” dhe “familjare me palë kundërshtare”, gjykimi ka përfunduar në çdo rast brenda standardit minimal kohor në fuqi sipas kritereve matëse të miratuara me vendimin nr. 261/2, viti 2010, të KLD-së.

Për sa më sipër, duke iu referuar në tërësi kohëzgjatjes së gjykimit për 12 çështjet për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, për shkak se standardi minimal kohor është respektuar nga gjyqtarja për të dyja kategoritë të cilave iu përkasin çështjet e analizuara, gjyqtarja duhet të vlerësohet për këtë tregues me pikët maksimale.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara, dhe për pasojë, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, për shkak se në të gjitha çështjet e analizuara, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara në procesin e rivlerësimit kalimtar, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e posaçme (Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në periudhën e vlerësimit) dhe nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 9 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit⁴⁷.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për kategori, rezulton si më poshtë:

- Për kategorinë e çështjeve “penale krime”, për 5 çështjet e vëzhguara (të gjitha çështjet e marra në analizë janë çështje penale krime), 2 çështjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 148 ditë ose rreth 4 muaj e 5 ditë⁴⁸. Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara të kësaj kategorie, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale të themelit në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm.*
- Për kategorinë e çështjeve “familjare me palë kundërshtare”, për 7 çështjet e vëzhguara⁴⁹, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për kategorinë e çështjeve “familjare me palë kundërshtare”, rezulton të jetë rreth 78 ditë ose rreth 2 muaj e 18 ditë. Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara të kësaj kategorie, është më e shkurtër se standardi minimal kohor 4/muaj për gjykimin e çështjeve familjare me palë kundërshtare.*

⁴⁷ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” *Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.*”

⁴⁸Çështjet që i përkasin vendimeve nr. 109, datë 10.2.2014 të GJ.Rr.Gj.Elbasan dhe vendimeve nr. 45, datë 06.04.2016, nr. 22, datë 03.03.2016, nr. 42, datë 04.04.2016, nr. 107, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁴⁹Çështjet që i përkasin vendimeve nr. 1734, datë 05.12.2014, nr. 1748, datë 09.12.2014, nr. 476, datë 10.03.2014, nr. 2521, datë 19.12.2013, nr. 515, datë 17.03.2014, nr. 29, datë 12.01.2015 dhe nr. 1411, datë 06.10.2014 të GJ.Rr.Gj.Elbasan.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të dy kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Lidhur me ngarkesën sasiore për periudhën 2014-2016 gjyqtare {...} ka deklaruar të dhëna statistikore duke iu referuar të dhënave të pasqyruara në shkresën përcjellëse nr. 10957 prot, datë 17.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan sipas të cilës në këtë gjykatë i janë caktuar 1686 çështje dhe ka përfunduar 1706 çështje, ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë i janë caktuar 145 dhe ka përfunduar 127, ndërsa për vitin 2017 ka mbartur 3 çështje penale. Bazuar në këtë të dhëna rendimenti i përfundimit të çështjeve është 105.5 %...Referuar mbledhjes aritmetike të të dhënave të tabelave detajuese rezulton se ka mospërputhje midis tyre me të dhënat e shkresës përcjellëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e për rrjedhojë edhe me ato të deklaruara nga subjekti. Sipas këtyre të dhënave i janë caktuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan 1042 çështje dhe ka përfunduar 990 çështje. Në total, duke përfshirë edhe të dhënat për Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton se i janë caktuar 1187 çështje dhe ka përfunduar 1127 çështje. Bazuar në këto të dhëna rendimenti i përfundimit të çështjeve është 95 %.”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjatë periudhës së punës tetor 2013-14 korrik 2015 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, gjyqtarja ka përfunduar, për çdo vit, çështjet si më poshtë:

Për vitin 2013(7.10.2013-31.12.2013), gjyqtarja ka përfunduar gjithsej 112 çështje nga të cilat 77 civile themeli (çështje familjare), 7 urdhra mbrojtje, 3 kërkesa civile dhe 26 kërkesa administrative penale.

Për vitin 2014 (1.1.2014-31.12.2014), gjyqtarja ka përfunduar 477 çështje nga të cilat 296civile themeli (çështje familjare), 7 urdhra mbrojtje, 14 kërkesa civile, 18 penale themeli, dhe 142 kërkesa administrative penale.

Për vitin 2015 (1.1.2015-14.7.2015), gjyqtarja ka përfunduar 103 çështje nga të cilat 188 civile themeli (çështje familjare), 26 urdhra mbrojtje, 10 kërkesa civile, 7 penale themeli, dhe 79 kërkesa administrative penale.

Gjatë periudhës së punës 15 korrik 2015 deri në 8 tetor 2016, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 27 çështje, nga të cilat 10 çështje penale themeli dhe 17 kërkesa penale administrative.

Në tabelat me të dhëna statistikore nuk administrohen të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara për çdo vit kalendarik, për të mundësuar ri llogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur për llogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 95 % i përcaktuar në faqen 32 të Raportit, faqe 518 e dosjes së rivlerësimit.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 95 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja pikëzohet me 8 pikë, pasi ky rendiment është në masën 95 %.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që përmbajnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

- Informacioni i përcjellë nga gjykata⁵⁰ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar Raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *“..Nga 5 raste të vëzhguara arsyetimi i vendimit gjyqësor rezulton të jetë kryer për 2 ditë (dosja 3), 3 ditë (dosja 4), 4 ditë (dosja 5), dhe për 5 ditë (dosja 1 dhe 2). Në të gjitha rastet arsyetimi i vendimit është bërë brenda afateve 5 dhe 10 ditore të parashikuara nga nenet 113 të K.Pr.P dhe 308 të K.Pr.C. Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore rezulton të jetë me 3.4 ditë.”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- i) Dosja 1, çështje e kategorisë “kërkesa penale”, që i përket vendimit me nr. 210, datë 19.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është dorëzuar më datë 24.12.2015, brenda 5/ditëve.
- ii) Dosja 2, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, që i përket vendimit me nr. 1734, datë 05.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është dorëzuar më datë 10.12.2014, brenda 5/ditëve;
- iii) Dosja 3, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, që i përket vendimit me nr. 1748, datë 09.12.2014 është dorëzuar më datë 11.12.2014, brenda 2/ditëve;
- iv) Dosja 4, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare” që i përket vendimit me nr. 476, datë 10.03.2014, është dorëzuar më datë 13.03.2014, brenda 3/ditëve;
- v) Dosja 5, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, që i përket vendimit me nr. 2521, datë 19.12.2013, është dorëzuar më datë 23.12.2013, brenda 4/ditëve;

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit, rezulton se:

- vi) Dosja 6, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, që i përket vendimit me nr. 515, datë 17.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është dorëzuar më datë 20.03.2014, 3/ditë;
- vii) Dosja 7, çështje e kategorisë “penale krime”, që i përket vendimit me nr. 109, datë 10.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është dorëzuar më datë 13.02.2014, 3/ditë;
- viii) Dosja 8, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, që i përket vendimit me nr. 29, datë 12.01.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është dorëzuar më datë 15.01.2015, 3/ditë;
- ix) Dosja 9, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare” me objekt “urdhër mbrojtje”, që i përket vendimit me nr. 82, datë 08.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është dorëzuar më datë 10.10.2014, 2/ditë;
- x) Dosja 10, çështje e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, që i përket vendimit me nr. 1411, datë 06.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është dorëzuar më datë 08.10.2014, 2/ditë;

⁵⁰ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nëpërmjet postës elektronike më datë 06.10.2020.

xi) Dosja 11, çështje e kategorisë “penale krime”, që i përket vendimit me nr. 45, datë 06.04.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është dorëzuar më datë 11.04.2016, 5/ditë;

Duke iu referuar kategorive të çështjeve, si më sipër, rezulton se:

- koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë “familjare me palë kundërshtare” (dosja 2,3,4,5,6,8,9,10), koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor është **3 ditë, më e shkurtër se afati 10/ditor i parashikuar nga neni 306, pg 2 i K.Pr.C⁵¹**.
- koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak” (dosja 1, vendimi nr. 210, datë 19.12.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda) është **5 ditë**;
- koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë “penale krime” (dosja 7, vendimi nr. 109, datë 10.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dosja 11, vendimi me nr. 45, datë 06.04.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda) është **4 ditë**;

Ne lidhje me afatin e arsyetimit të vendimeve penale, referuar parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve të tij me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10/ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë. Duke qenë se koha mesatare e dorëzimit të vendimit të arsyetuar nga ana e gjyqtarës në rastin konkret, është 5 ditë për një kategori dhe 4 ditë për kategorinë tjetër, ajo është më e shkurtër se gjysma e afatit të ankimit.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar për të gjitha kategoritë për të cilat ka të dhëna, rezulton të jetë “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

⁵¹ Në nenin 308 pg 2 të K.Pr.C, sipas dormulimit të këtij neni para ndryshimeve në vitin 2017, parashikohej se :” Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në pesë ditë.”.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“..Subjekti i rivlerësimit {...} është efektive në përfundimin në kohë dhe pa vonesa të gjykimeve, që është tregues i lidhur me aftësinë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim. Një tipar i tillë i punës së saj është vënia në lëvizje menjëherë dhe pa vonesa e çështjeve, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës së pajtimit apo asaj përgatitore. Veprimet përgatitore të kryera janë dokumentuar në procesverbal, të rregullt nga pikëpamja formale. Veprimet e pajtimit gjithashtu janë dokumentuar në procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale ku evidentohet zbatimi me përpikmëri i parashikimeve të nenit 134 dhe 135 të Kodit të Familjes mbi procedurën e ndjekur në këtë rast. Për çdo veprim përgatitor apo pajtimi, gjyqtarja ka bërë pjesë të procesverbalit edhe aktin e nënshkrimit të palëve ku konfirmohet marrja dijani e tyre për seancës pasardhëse. Tek një çështje e vëzhguar e natyrës kërkesë me objekt “sekuestrim i të dhënave kompjuterike” planifikimi i seancës gjyqësore dhe përfundimi i gjykimit është kryer në më pak se 24 orë, në përputhje me përcaktimet e nenit 208/a pika 2 të K.Pr.P. Në katër dosjet civile të vëzhguara janë zhvilluar 18 seanca nga të cilat 4 seanca kanë qenë joproductive. Shkak i jo produktivitetit rezulton të ketë qenë në 2 raste përsëritja e njoftimit për të paditurin, i cili nuk rezultonte të kishte dijani për seancën, njoftim i cili është realizuar me shpallje...1 rast me kërkesë të paditësit për shkaqe familjare..1 rast për ripërsëritje të njoftimit për të paditurin megjithëse i njoftuar rregullisht në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 135/2 të Kodit të Familjes (dosja 2)....”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short⁵².

⁵² Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse. Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 10 prej tyre janë çështje me palë kundërshtare, nga të cilat 2 i përkasin kategorisë “penale krime” (dosja 7 dhe dosja 11) dhe 8 i përkasin kategorisë “familjare me palë kundërshtare (dosja 2,3,4,5,6,8,9,10).

Lidhur me numrin e seancave gjyqësore për secilën kategori, duke përjashtuar seanca përgatitore ose të pajtimit, rezulton si më poshtë:

- **Për kategorinë penale krime** (i) për çështjen që i përket dosjes 7 (çështja që i përket vendimit nr. 109, datë 10.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan), janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore nga të cilat një seancë është joproduktive pasi është shtyrë për të siguruar pjesëmarrjen e prokurorisë ndërsa për çështjen që i përket dosjes 11 (çështja që i përket vendimit nr. 45, datë 06.04.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda), janë zhvilluar 2 seanca gjyqësore të cilat janë produktive. Për këtë kategori, numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2.5 seanca gjyqësore.
- **Për kategorinë “familjare me palë kundërshtare”,** rezulton si më poshtë:
 - i) Dosja 2, çështja që i përket vendimit nr. 1734, datë 05.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është zhvilluar 1 seancë gjyqësore produktive;
 - ii) Dosja 3, çështja që i përket vendimit nr. 1748, datë 09.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore produktive. Seancat janë shtyrë me qëllim njoftimin e ekspertës psikologe dhe për t’i dhënë kohë asaj për të kryer aktin e ekspertimit;
 - iii) Dosja 4, çështja që i përket vendimit nr. 476, datë 10.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë zhvilluar 2 seanca gjyqësore produktive. Seanca e parë është shtyrë me kërkesë të palës paditëse për t’i dhënë kohë për të paraqitur prova shkresore;
 - iv) Dosja 5, çështja që i përket vendimit nr. 2521, datë 19.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore produktive. Seancat janë shtyrë me qëllim njoftimin e ekspertës psikologe dhe për t’i dhënë kohë asaj për të kryer aktin e ekspertimit;
 - v) Dosja 6, çështja që i përket vendimit nr. 515, datë 17.03.2014.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore produktive. Seancat janë shtyrë me qëllim njoftimin e ekspertës psikologe dhe për t’i dhënë kohë asaj për të kryer aktin e ekspertimit, ndërsa një seancë është shtyrë me kërkesë të palës paditëse si dhe për të mundësuar njoftimin e të paditurit;
 - vi) Dosja 8, çështja që i përket vendimit nr. 29, datë 12.01.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore produktive. Seancat janë shtyrë me qëllim njoftimin e ekspertës psikologe dhe për t’i dhënë kohë asaj për të kryer aktin e ekspertimit;
 - vii) Dosja 9, çështja që i përket vendimit nr. 82, datë 08.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë zhvilluar 2 seanca gjyqësore produktive.
 - viii) Dosja 10, çështja që i përket vendimit nr. 1411, datë 06.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është zhvilluar 1 seancë gjyqësore produktive.

Sa më sipër, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “familjare me palë kundërshtare” është 2.25 seanca. Numri i seancave joproduktive është tepër i ulët dhe nuk rezulton në asnjë rast që seancat të jenë shtyrë apo të mos jenë zhvilluar për shkaqe që lidhen me menaxhimin e procesit nga gjyqtarja, pasi shkak për shtyrje kanë qenë kryesisht nevojat

procedurale të gjykimit (për të njoftuar ekspertin dhe për ti dhënë kohë asaj për të kryer aktin e ekspertimit psikologjik) ose kërkesat e palëve (për të paraqitur prova).

Sa i përket kryerjes së veprimeve procedurale për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, gjyqtarja ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për të siguruar zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të gjykimit si dhe për të shmangur seancat joproduktive, çka reflektohet në :

- (i) numrin e ulët të seancave joproduktive, vetëm 2 në 23 seanca gjyqësore të zhvilluara;
- (ii) shkaqet e jo produktivitetit të tyre (një seancë për të siguruar prezencën e prokurores, dosja 7, dhe një për ti dhënë kohë palës paditës për të paraqitur prova shkresore, dosja 6);
- (iii) kohën e planifikimit të tyre në shumicën e rasteve menjëherë ose vetëm pak ditë pas caktimit me short si dhe shtyrjen e tyre brenda afateve të arsyeshme ;
- (iv) veprimet procedurale të ndërmarra nga gjyqtarja për të siguruar zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave të tilla si njoftimi që në seancën e parë i prindërve dhe psikologes për të asistuar të pandehurit e mitur (dosja 11) apo njoftimi i palëve nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore në rastin e urdhrit të mbrojtjes (dosja 9).

Gjithashtu, nga aktet e dosjeve të vëzhguara rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë, çka ka sjellë si pasojë mos dështimin në asnjë rast të seancave për shkak të mungesës apo paqartësisë së njoftimeve.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve⁵³ të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “penale krime” është 2.5 seanca dhe për kategorinë “familjare me palë kundërshtarë” është 2.25 seanca.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, numri mesatar i seancave gjyqësore është më i vogël se 3 seanca dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara, është më i ulët se 3 seanca për të dy kategoritë e çështjeve për të cilat ka të dhëna dhe rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproduktive.

⁵³ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse”.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Gjyqtarja {...} merr masat dhe planifikon seancat gjyqësore në afate normale gjykimi. Në 18 seancat e çështjeve civile të vëzhguara, planifikimi i tyre është realizuar nën afatin 30 ditë (dosjet 2,3,4 dhe 5). Në çështjet penale të vëzhguara planifikimi i seancës dhe përfundimi i gjykimit ka zgjatur një ditë (dosja 1). Në tërësi gjyqtarja mbikëqyr kryerjen e njoftimeve nga sekretaria gjyqësore, ndërsa shtyrjet e gjykimeve për njoftimin e tyre kanë ndodhur për shkaqe procedurale dhe në asnjë rast nuk ka dështuar seanca për mos njoftimin e palëve ndërgjyqëse nga administrata gjyqësore. Në dosjet e vëzhguara të gjitha seancat e pajtimit, përgatitore dhe gjyqësore dokumentojnë vendin e zhvillimit të gjykimit. Nuk rezultojnë seanca të regjistruara në sistem audio për shkak të mungesës së infrastrukturës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo e fundit ka konfirmuar se në periudhën e rivlerësimit është punuar në godinën e vjetër të gjykatës ku nuk ka funksionuar sistemi i regjistrimit audio për çështjet civile, sistem i cili ka qenë i instaluar vetëm në dy salla gjykimi dhe i aksesueshëm vetëm për çështjet penale. Të gjitha seancat rezultojnë të kenë filluar në orarin e përcaktuar nga gjyqtarja në respektim të nenit 4 të vendimit nr. 238/1/b datë 24.12.2008 të KLD-së...Gjatë gjykimit gjyqtarja {...} identifikon veprimet procedurale që duhet të kryhen dhe zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, njohjen në çdo rast me të drejtat dhe detyrimet procedurale, prezantimin e gjykatës, debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në shpalljen e vendimit. Në çështjet e vëzhguara nuk janë konstatuar mangësi në njohuritë procedurale të gjyqtarës si të natyrës penale, civile dhe familjare.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare, të kategorisë “penale krime” dhe “familjare me palë kundërshtare” dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak (dosja 1).

Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë të pajtimit ose gjyqësore në çështjet civile-familjare, në çdo rast 0 deri 5 ditë pas caktimit të çështjes me short dhe në çështjet penale, brenda 10 ditëve nga caktimi me short, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale. Në një çështje me karakter emergjent e cila është kërkesë penale e fazës së hetimit paraprak (dosja 1) seanca është caktuar menjëherë pas regjistrimit dhe shortimit të saj dhe gjykimi është planifikuar dhe përfunduar ditën e nesërme, ndërsa në një çështje me objekt “lëshim i urdhrorit të

menjëhershëm të mbrojtjes” seanca është planifikuar dhe zhvilluar ditën e regjistrimit të saj në gjykatë, duke respektuar afatin ligjor 48 orë të përcaktuar nga ligji i posaçëm, ndërsa seanca e verifikimit është caktuar brenda 20 ditëve duke respektuar afatin ligjor të përcaktuar po në këtë ligj (dosja 9).

Seancat gjyqësore për 2 dosjet që i përkasin çështjeve penale të themelit (dosja 7 dhe dosja 11), janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.P. Në rastin e shqyrtimit të kërkesave së prokurorisë në lidhje me kërkesat penale të hetimit paraprak për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi (dosja 7 e cila përbën çështje themeli me gjykim të drejtpërdrejtë, brenda së cilës është zhvilluar edhe seanca e parë për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi) apo sekuestrimin e të dhënave kompjuterike (dosja 1) gjyqtarja ka marrë masa efektive për të mundësuar planifikimin dhe zhvillimin e seancave brenda afatit ligjor 48 orësh në rastin e vleftësimit të arrestit dhe brenda ditës në rastin e kërkesës për sekuestrim të dhënash, duke respektuar parashikimet e nenit 259 dhe 208/a pg 2 të K.Pr.P. Seancat gjyqësore të zhvilluara për shqyrtimin e çështjeve penale kanë ndjekur në çdo rast ecurinë procedurale sipas parashikimeve të nenit 355 e vijues të K.Pr.P dhe atë të nenit 405 të K.Pr.P në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar (dosja 7 dhe dosja 11) . Në çështjet me të pandehur të mitur (dosja 11) gjyqtarja ka zbatuar rregullat e posaçme të gjykimit në prezencë të prindit dhe psikologut në referim të parashikimeve të nenit 35 të K.Pr.P, duke marrë masa për njoftimin e tyre që në vendimin për caktimin e seancës së parë gjyqësore.

Në çështjet civile të llojit familjare me palë kundërshtare, seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të arsyeshme, duke mundësuar zhvillimin e gjykimit brenda një kohë të shkurtër. Gjithashtu, në këto çështje rezulton se gjyqtarja ka zhvilluar, veprimet përgatitore në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 134 dhe 135 të Kodit të Familjes, duke njoftuar palët për tu paraqitur personalisht, njoftimin e të paditurit dy herë për seancën e pajtimit sipas pg 2 të nenit 135, si dhe thirrjen për pajtim të palëve. Seancat gjyqësore në çështjet civile kanë ndjekur të gjithë hapat procedurale të nevojshëm për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, respektimin e të drejtave të palëve, lejimin e provave, administrimin e tyre, caktimin e ekspertit psikolog në rastet në rastet kur palët kanë patur fëmijë të mitur në referim të nenit 5 dhe 166 të Kodit të Familjes, pyetjen e fëmijëve të mitur kur kjo është vlerësuar e domosdoshme nga gjykata (dosja 6).

Seancat e pajtimit për çështjet familjare janë dokumentuar rregullisht në procesverbalin e mbajtur nga gjyqtarja, ndërsa seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara, janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me dorëshkrim, për shkak se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, siç referohet në raportin analitik të rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, nuk ka funksionuar plotësisht sistemi i regjistrimit audio, ndërsa seancat për gjykimet e zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda janë regjistruar në sistem audio dhe janë dokumentuar nëpërmjet shënimeve të mbajtura nga sekretarja gjyqësore për ecurinë e gjykimit (dosja 1 dhe dosja 11).

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjykimit në mungesë sipas parashikimeve të nenit 179 të K.Pr.C, sipas rastit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve,

shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në rastin e çështjeve penale), lejimin dhe administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë me disa minuta, shoqëruar me relatimin e shkakut që ka pasjellë vonesën në çeljen e seancës, por nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese, apo që gjykimi të ketë filluar me vonesë për shkaqe që lidhen me masat organizative të gjyqtarës.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal ose civil, në seancat e pajtimit, përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short u konstatua se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën, vendin si dhe veprimet që kryhen në seancë.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e 11 dosjeve të administruara janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin kronologjik, sipas datës së krijimit të aktit (për aktet e gjykatës) apo datës së paraqitjes së tij (për aktet e paraqitura nga palët). Vetëm në dosjet 1 dhe 11 të cilat i përkasin çështjeve të gjykuara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, aktet janë renditur në mënyrë logjike (sipas përmbajtjes) dhe kronologjike brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve, pavarësisht rregullit të ndjekur, nuk vështirëson aksesin në dosje dhe i bën ato lehtësisht të shfrytëzueshme nga gjykata më e lartë apo lexuesi.

Dosjet penale përmbajnë, urdhrin e formimit të turpfit gjykues (dosja 11), vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe, sipas rastit provat bashkëlidhur bashkë me diskutimin përfundimtar në lidhje me personalitetin e të pandehurit dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Në dosjet civile aktet janë renditur sipas datave dhe konkretisht përmbajnë aktin e shortit, padinë, provat shkresore të paraqitura nga pala paditëse, aktet e përfaqësimit, provat e paraqitura nga pala e paditur, aktin e ekspertimit të kryer në gjykim (kur është kryer një i tillë), vendimin për caktimin e seancës së pajtimit, aktet e njoftimit dhe procesverbalet e seancave të pajtimit sipas datave, vendimin e caktimit të seancës gjyqësore, njoftimet dhe procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin përfundimtar dhe vendimin për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Të gjitha dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Në pesë dosjet e vëzhguara janë përfshirë rregullisht padia dhe provat e paraqitura nga paditësi në procesin civil apo kërkesa për gjykim dhe provat përkatëse, vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës së

parë përgatitore ose gjyqësore, aktet e njoftimit të palëve dhe provat e paraqitura prej tyre, procesverbali përgatitor, i pajtimit dhe ai gjyqësor, parashtrimet e palëve dhe vendimi gjyqësor..”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*padia dhe provat shkresore të palës paditëse, provat e palës së paditur, akti i ekspertimit të kryer gjatë gjykimit, provat e administruara për herë të parë në seancë për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, diskutimet përfundimtare të palëve*). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “..Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 -8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} nuk rezulton asnjë e dhënë negative në këtë aspekt. nuk ka ankesa

të paraqitura dhe të verifikuara mbi etikën në punë. edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultojnë të dështime të seancave për mugnesë të gjyqtarës.”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, sipas raportit analitik të rivlerësimit, referuar regjistrin të ankesave, rezulton se gjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtaren {...} është paraqitur një ankesë, në vitin 2015, në Inspektoratin e KLD-së, ankesë e cila pas shqyrtimi fillestar është arkivuar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. Nga informacioni i administruar në procesin e rivlerësimit, me shkresën nr. 3086/2 prot, datë 13.10.2017 të Inspektoratit të KLD-së, rezulton se bëhet fjale për ankesën me nr. 1628 prot, datë 11.05.2015 të shoqërisë Ekobeton shpk, ankesë e cila ka përfunduar me arkivim me arsyetimin se pretendimet e ankuesit zgjidhen nëpërmjet mjeteve të apelimit të vendimit gjyqësor.

Nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 208 datë 08.11.2019, rezulton se KPK edhe pse e ka shtrirë vlerësimin e aftësive profesionale para vitit 2013, nuk ka konstatuar të dhëna që mund të ndikonin në vlerësim lidhur me etikën e gjyqtarës.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.”*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton të jetë paraqitur vetëm një ankesë, referuar dhe analizuar në treguesin më sipër, e cila është verifikuar nga Inspektorati i KLD dhe është arkivuar me arsyetimin se pretendimet e ankuesit zgjidhen nëpërmjet mjeteve të ankimit në gjykatat më të larta, duke mos u konstatuar asnjë e dhënë për shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: *“Komisioni, bazuar në analizën financiare, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi dhe burime financiare të ligjshme, për vitet 2008-2016, në të cilat ka ushtruar funksionet e prokurores. Nga administrimi i shkresave dhe provave të tjera që ndodhen në dosjen e Komisionit lidhur me hetimin e kryer, nuk rezultuan indicie lidhur me vlerësime të fakteve dhe rrethanave të tjera për kriterin e pasurisë...Për vlerësimin e pasurisë: Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti ka kryer deklarim të saktë të pasurive dhe interesave private, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Ajo nuk është përprjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, të saj. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj.{...}, për kriterin e 32 vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato cash), dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare..”*

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 208, datë 08.11.2019, sa i përket vlerësimit të figurës, konkluzohet se :” *Për vlerësimin e figurës: Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “*Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe 5 dosjet e vëzguara nuk janë evindetuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes. në 3 nga 5 dosjet e vëzhguara pjesë e shqyrtimit gjyqësor dhe disponimi me vendim përfundimtar kanë qenë çështje që lidhen me të miturit, si lënia e tyre për rritje dhe edukim dhe përcaktimi i detyrimit për ushqim në favor të të miturit (dosja 3,4 dhe 5). Asnjë prej dokumenteve ligjore nuk lidhet me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore, të pakicave apo të të miturve...Nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.”.*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Në çështjet me të mitur, posaçërisht në një çështje familjare ku fëmija i mitur është pyetur para gjykatës (dosja 6) dhe në një çështje me të pandehur të mitur (dosja 11) gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për respektimin e të drejtave të tyre si dhe rezulton të ketë përdorur gjuhë të kujdesshme në drejtimin e seancës dhe zhvillimin e procesit gjyqësor.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga gjyqtarja.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, lidhur me kërkesat për përjashtim, nuk ka të dhëna.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarës, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e saj.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës {...} në periudhën e vlerësimit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtare {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, goftë në seancat përgatitore, të pajtimit apo edhe ato gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore, të pajtimit e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nga të dhënat e regjistrave të ankesave nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa për shkelje të etikës gjyqësore apo që lidhen me komunikimin e gjyqtarës..”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultojnë se:

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezultojnë se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces, është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën zhvillohet debati gjyqësor.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (institucioneve të paraburgimit, drejtorive të policisë etj, për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve...etj) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, nuk ka të dhëna specifike.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cënim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit penal ose civil. Në një çështje në të cilën i pandehuri ka qenë në moshë të mitur (dosja 11), gjyqtarja rezulton të ketë respektuar me korrektësi normat procedurale për pjesëmarrjen e të pandehurve në gjykim nën asistencën e mbrojtësve, psikologut dhe prindërve të të pandehurve (dosja 10), duke garantuar mbrojtjen e posaçme të të dhënave personale dhe konfidencialitetit. Gjithashtu në çështjet familjare ky gjykata ka shqyrtuar dhe vendosur për të drejtat e fëmijeve të mitur lidhur me lënien e tyre për rritje dhe edukim si dhe caktimin e detyrimit për ushqim ndaj tyre apo pyetjen e të miturti në seancë (dosja 6), janë respektuar normat ligjore procedurale për pyetjen në prani të psikologut apo kryerjen e aktit të ekspertimit psikologjik, sipas parashikimeve të nenit 5 dhe 166 të Kodit të Familjes.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me dy treguesit aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore (4.b.a dhe 4.b.b), në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta mbi aftësinë e gjyqtares {...} për të

bashkëpunuat me kolegët dhe administratën gjyqësore. Në këtë aspekt konstatohet se nuk ka patur asnjë vonesë në arsyetimin e vendimeve gjyqësore si e dhënë e tërthortë, ndërsa nuk ka dëshmtime të seancave për shkak të moskryerjes së njoftimeve në kohë, çfarë tregon produktivitetin e punës së saj në këtë aspekt.”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimit i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, vlerësohet se gjyqtarja {...} ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;

- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga tre burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social ...etj, duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, vlerësohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “..Në periudhën e vlerësimit ajo ka marrë pjesë në 17 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 28 ditë trajnimi gjithsej, ndërsa është certifikuar në 17 raste, për shkak se në një trajnim ka marrë pjesë vetëm 1 ditë. Lënda e trajnimeve ku ajo ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë në gjykimin e çështjeve civile apo penale si dhe në gjykimin e çështjeve në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Gjyqtarja ka marrë pjesë në sesionin e 37-të mbi “Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e viktimës”, organizuar nga Instituti i të Drejtave të Njeriut në

Strasbourg, Francë, për periudhën kohore 03-28 korrik 2006, pra jashtë periudhës së vlerësimit.”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, vërtetimit me nr. 641 prot, datë 20.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës, dhe formularit të vetë deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtarja Daniela Shikra ka marrë pjesë në 17 aktivitete trajnuese pjesë e Programit të Formimit Vazhdues, të cilat fillojnë më aktivitetin e datave 18-19 nëntor 2013 dhe përfundojnë me aktivitetin e datës 20 prill 2016, gjithsej 29 ditë trajnimi.

Nga aktet e dosjes së rivlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtares në aktivitete të tjera trajnuese, jashtë këtij programi, që i përkasin periudhës së vlerësimit.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 17 aktivitete trajnuese, në programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 29 ditë.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës familjare, civile, penale dhe procedurale penale, gjithsej në 17 aktivitete të zhvilluara për 29 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh.M dhe trajnime të tjera profesionale është nga 15-120 ditë duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se ajo është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës vetëm në cilësinë e pjesëmarrësit. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e saj në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera, në cilësinë e ekspertës.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në formularin e vetë deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk referohet të dhëna për angazhimin e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016. Gjithashtu, duke iu referuar Raportit analitik të rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me këtë tregues.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3

pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUSIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Sipas formularit të vetëdeklarimit për aftësitë profesionale dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtares, nuk rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike, gjatë periudhës së vlerësimit.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUSIONE:

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna për realizimin e publikimeve ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzimi është me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	87	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	376	Shumë mirë